

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje në aktivizëm qytetar dhe avokim.....	3.
2. Institucionet në nivelin lokal në Kosovë.....	4.
3. Si të organizohen qytetarët rreth një nisme.....	7.
4. Të mbledhësh informacionin adekuat.....	10.
5. Krijimi i planit të veprimit.....	13.
6. Strategjitë për ndikimin tek zyrtarët.....	15.
7. Premtimet e dhëna nga zyrtarët dhe mënyra se si të përcjelllet përmbushja e tyre.....	17.
8. Përfundimet dhe këshillat për startegjitë e suksesshme avokuese.....	18.
9. Anekset.....	19.
9.1 Shembulli i rendit të ditës – Hyrje në avokim dhe identifikimi i çështjes	19.
9.1 Shembulli i planit të veprimit për avokim.....	22.

PËR KAMPANJËN “DREJTËSIA DHE QYTETARËT”

Kampanja “Drejtësia dhe qytetarët” është një lëvizje e cila mbledh së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile në Kosovë që të punojnë në reformën në sistemin e drejtësisë dhe promovon ndryshimin përmes avokimit publik. Qëllimi i kampanjës është që të promovojë një sistem gjyqësor më të drejtë dhe të përgjegjshëm si dhe të rrisë reagimin karshi nevojës të qytetarëve. Kampanja ndërthet në vehte tre shtylla kryesore, të cilat së bashku përkrahin misionin e saj:

1. Edukimi publik kombëtar dhe kampanja për avokim
2. Klinikat për ndihmë ligjore falas
3. Iniciativat strategjike të çështjeve gjyqësore

Edukimi publik kombëtar dhe kampanja për avokim

Kampanja “Drejtësia dhe njerëzit” promovon edukimin në sistemin e drejtësisë dhe avokon drejtëpërdrejt për reformat në nivelin kombëtar përmes partnerit implementues Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Aktivitetet përfshijnë punëtori mbi edukimin publik në dhjetëra komuna në tërë Kosovën, trajnime avokuese që të mësojnë qytetarët se si të avokojnë për reforma në Kosovë, tryeza me ekspertë që të ndihmojnë të identifikojnë reformat në sistemin e drejtësisë si dhe avokime direkte për reformat e politikave publike në një spektër të gjerë çështjesh siç janë:

- Përmirësimi i mekanizmit të paraqitjes disiplinore i përdorur nga institucionet e sistemit të drejtësisë
- Publikimi i emrave të gjyqëtarëve dhe prokurorëve të cilët janë shpallur fajtorë për sjellje të pahijshme
- Miratimi i broshurës zyrtare të Policisë së Kosovës e cila i informon viktimat e dhunës në familje mbi të drejtat e tyre ligjore si dhe burimeve të tyre publike që janë në dispozicion të tyre
- Emërimi i gjyqëtarëve dhe prokurorëve që të veprojnë si specialist në rastet e dhunës në familje

Klinikat për ndihmë ligjore falas

Drejtësia dhe qytetarët ju ofron qytetarëve në nevojë këshillë ligjore dhe asistencë pa pagesë, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në fushat e së drejtës penale dhe procedurave si dhe në përdorimin e ankesës dhe mekanizmit të mbikëqyrjes në sistemin e drejtësisë. Partneri implementues, Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD) e drejton klinikën e ndihmës juridike në Prishtinë si dhe klinikën javore në tetë komuna të Kosovës, përfshirë Gjilanin, Malishevën, Graçanicën, Vushtrrinë, Ferizajin, Drenasin, Fushë Kosovën dhe Mitrovicën.

Iniciativat strategjike për çështjet ligjore

Kampanja “Njerëzit dhe Drejtësia” synon që të fuqizojë të drejtat e qytetarëve si dhe të krijojë precedent përmes iniciativës strategjike për çështjet ligjore. Duke punuar përmes partnerëve implementues të zyrave ligjore, Sejdiu dhe Qerkini, LLC, Kampanja ofron përfaqësim falas ligjor për klientët në rastet kur ata bëjnë pyetje me rëndësi lidhur me sistemin e drejtësisë.

Drejtësia dhe njerëzit në veri të Kosovës

Kampanja “Drejtësia dhe njerëzit” përkrah angazhimin aktiv të qytetarëve në veri të Kosovës në avokim në nivelin lokal në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve përmes partnerit implementues Qendrën Avokuese për Kulturën Demokratike (ACDC). Aktivitetet përfshijnë trajnimin dhe përkrahjen e aktivistëve lokal në implementimin e kampanjave lokale avokuese, si dhe ngjarjeve publike të aktivizmit qytetar si dhe sundimit të ligjit në veri të Kosovës.

I. Hyrje në aktivizmin qytetar dhe avokim

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre është një nga aspektet kryesore të një shoqërie demokratike. Avokimi, apo procesi i propozimit kolektiv të zgjidhjeve konkrete për problemet tek vendimarrësit relevant, është një metodë primare për t'u siguruar se zëri i qytetarëve po dëgjohej nga institucionet të cilat i përfaqësojnë ata. Jo vetëm se avokimi është një element kritik i procesit demokratik, por njëherit është rruga më e mirë që të mbajë qeveritë të përgjegjshmëe për vendimet e tyre dhe njëherit të sigurohet që institucionet të funksionojnë më mirë. Qytetarë aktiv dhe të përfshirë ndihmojnë zyrtarët qeveritarë që të dijnë se cilat janë problemet dhe prioritetet në komunitetet e tyre, si dhe i drejton drejt një politikëbërje më të mirë.

Derisa të gjitha llojet e vullnetarizmit dhe të përfshirjes qytetare mund të përmirësojnë shoqërinë, avokimi përmban kërkesën për diçka konkrete nga institucionet. Veprimet vullnetare siç janë grupet qytetare që mbledhen të pastrojnë një park, apo mbledhja e donacioneve për familjet në nevojë nuk përfaqësojnë avokimin, në tërësi këto ata vullnetarë i zgjidhin direkt çështjet në vend që të kërkojnë veprime nga ana e qeverisë. Në disa raste veprimet vullnetare mund të kenë ndikim të madh, por të shumtën e herave një iniciativë avokuese që përpiket të ndikojë tek një institucion mund të ketë një jetëgjatësi më të madhe në ndryshimin e sjelljes qeveritare.

Mënyra më e mirë për qytetarët që të arrijnë deri tek rezultatet përmes avokimit është që të synojnë një angazhim konstruktiv me institucionet, duke përfshirë rekomandime konkrete se si mund të përmirësohen. Iniciativat qytetare të cilat vetëm i kritikojnë zyrtarët pa propozuar zgjidhje alternative të shumtën e rasteve nuk dërgojnë tek një përfaqësim më gjithëpërfshirës institucional apo vendime më të mira. Në Kosovë, roli i qytetarëve në avokim për reforma është ende një praktikë në zhvillim e sipër, dhe iniciativat qytetare të shumtën e rasteve ballafaqohen me sfida në bindjen e institucioneve për nevojën e marrjes parasysh të mendimit të tyre. Sido që të jetë, dersia institucionet e Kosovës vazhdojnë të zhvillohen, qytetarët e kanë një mundësi që të zgjerojnë këtë praktikë dhe të krijojnë institucione më bashkëpunuese dhe më të hapura.

Ky udhëzues është bazuar në përvojat e Qendrës avokuese për kulturën demokratike (ACDC) si pjesë e Kampanjës “Drejtësia dhe njerëzit” në organizimin e iniciativave avokuese në katër komunat në Kosovë – Leposaviq, Mitrovicë, Zubin Potok, dhe Zveçan. Është menduar si një mjet për çdo qytetar në Kosovë që të përdor si një bazë për organizimin e iniciativave në çështjet lokale. Rekomandimet dhe hapat e dhënë këtu paraqesin rezultatet e suksesshme në gjashtë kampanjat lokale avokuese dhe nuk mbulojnë strategjitë për avokim për institucionet qendrore, edhe pse shumë nga këta hapa do të ishin të ngjajshëm.



Aktivistët në veri të Mitrovicës shpërndajnë fletushka dhe posterë për iniciativën e sigurisë së studentëve

II. Institucionet në nivelin lokal në Kosovë

Në mënyrë që të organizosh një kampanjë të suksesshme të nivelit lokal në avokim, hapi i parë është që të kuptosh rolin e qeverisë komunale në Kosovë dhe të dish se si funksionojnë në praktikë. Ju nuk keni nevojë që të jeni një ekspert me njohuri juridike të qeverisjes komunale në mënyrë që t'i organizosh qytetarët rreth një iniciative, por vetëm njohuria e përgjithshme në rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve lokale është e mjaftueshme për përcaktimin se ku duhet që t'a fokusoni angazhimin e juaj. Ky seksion ofron një pasqyrë se si qeveritë lokale janë të organizuara në kontekstin e Kosovës. Për më shumë detaje, ju mund që t'i referoheni Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.¹

Vendimet më të rëndësishme që i bëjnë autoritetet në nivelin lokal janë Kuvendet Komunale si dhe Kryetari i Komunës. Çdo Kuvend Komunal ka numër të ndryshëm të anëtarëve duke u bazuar në numrin e popullatës, duke u radhitur nga 15 deri në 41, të cilët zgjedhen direkt me mandat katërvjeçar. Disa nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Kuvendit Komunal janë: miratimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i rregulloreve komunale; aprovimi i buxhetit dhe planeve të investimit; miratimi i planit vjetor të punës dhe raportit vjetor; përcaktimi i nivelit të taksave lokale dhe tarifave; dhe krijimi i simboleve komunale dhe emërtimi i rrugëve dhe hapësirave të tjera publike, në mesin e përgjigjesive të tjera.

Pozita e Kryetarit të Komunës është trupi më i lartë ekzekutiv i komunës i cili zgjedhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta për periudhën katërvjeçare. Përgjegjësitë më të rëndësishme të Kryetarit të Komunës janë që të përfaqësojë komunën, të udhëheq qeverinë komunale dhe administratën, të mbikëqyrë administratën financiare të Komunës, si dhe të përmbush detyra të tjera e që nuk janë në mënyrë eksplicite të përcaktuara për Kuvendin Komunal. Ai apo ajo është poashtu përgjegjës/e për të marrë vendime të Kuvendit Komunal si dhe të porpozojë buxhetin vjetor, planet zhvillimore si dhe të paraqesë rregullat komunale të Kuvendit Komunal për miratim. Për shkak të këtij pozicioni, në shumë pjesë të Kosovës, Kuvendet Komunale mund të konsultohen me zyrën e Kryetarit për udhëzime në çështje të ndryshme.

Çdo komunë poashtu ka një numër departamentesh të cilat mbulojnë çështje të caktuara specifike, siç janë planifikimi urban, mirëqenia sociale dhe shëndetësia, edukimi, kultura, rinia dhe sporti etj. Stafit në këto departamente janë shërbyes civil të cilat nuk janë të zgjedhur dhe të cilët ofrojnë vazhdimësi për ndryshim nga zyrtarët e zgjedhur. Në shumë raste, këto departamente mund të kenë autoritet që të zgjidhin çështje të caktuara lokale pa ndërhyrjen e Kuvendit Komunal apo Kryetarit, derisa në situata të tjera ata mund të kenë nevojë që të konsultohen me këta zyrtarë para se të përgjigjen në një kërkesë të caktuar. Pos të lartëpërmendurave, në disa komuna janë formuar edhe Zyra të zv. Kryetarit për komunitete, Këshilli për siguri, Këshilli për komunitete, si dhe Zyra për barazi gjinore. Këto mund të mos jenë të formuara në të gjitha komunat e Kosovës.

¹ <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2%2C191%2C249>



Shenjat e trafikut në Zveçan të vendosura nga Zyra lokale për planifikim urban si përgjigje e kampanjës avokuese të qytetarëve

Si mund të përfshihen qytetarët në vendim-marrje në nivelin lokal?

Janë një mori mekanizmash që janë në dispozicion të qytetarëve për përfshirje me zyrtarët në punët e administratës komunale. Këtu përfshihen takimet publike, e drejta në peticion, iniciativa qytetare, referendum si dhe komisione konsultative. Shumë nga këto procedura dhe mekanizma nuk përdoren shpesh në nivelin lokal në Kosovë, derisa në disa raste zyrtarët lokal mund të mos jenë të përgatitur që të përgjigjen në veprime të caktuara. Sido që të jetë, është me rëndësi që të ketë një mirëkuptim për këto mundësi pasi që ato mund të jenë mjete të dobishme si pjesë e një kampanje të gjithëmbarshme avokuese. Jo çdo mekanizëm mund të jetë i dobishëm për çdo iniciativë të dhënë, dhe grupet avokuese të qytetarëve duhet të marrin parasysh opcionet për dhe kundër për çdo çasje para se të ndjekin çfarëdo opcioni të dhënë më poshtë. Prsh, disa nga këta mekanizma kërkojnë mbledhjen e nënshkrimeve nga një numër i madh i bashkëqytetarëve, e cila mund të tërheq edhe burime nga aktivitetet e tjera potenciale.

Takimet publike

Çdo komunë është e obliguar që të mbajë takime me publikun të paktën dy herë në vit e ku mund të marrin pjesë individët si dhe organizatat. Data dhe dita e takimit duhet të publikohet të paktën dy javë më parë. Në takim, përfaqësuesit e komunës duhet t'i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës derisa pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje si dhe të ofrojnë propozime të përfaqësuesve të zgjedhur të komunës. Derisa institucionet lokale në Kosovë vazhdojnë të zhvillohen, këto takime mund të mos jenë të organizuara në orarin e njëjtë në të gjitha komunat, por ato ofrojnë një mundësi për qytetarët që të kenë kontakte të drejtpërdrejta me zyrtarët lokal.

Si shtesë e takimeve publike të lartpërmendura, komunat janë të obliguara që të informojnë qytetarët lokal për çfarëdo plani apo programi të interesit publik, dhe të ofrojë çasje në dokumentet zyrtare të komunës. Çdo qytetar mund të ketë çasje në cilindo dokument e i cili është në pronësi të komunës, vetëm nëse autoritetet komunale vendosin restriksion në përputhje me Ligjin për çasje në dokumentet zyrtare.

E drejta në peticion

Çdo qytetar lokal apo organizatë ka të drejtë që të prezantojë peticionin tek Kuvendi Komunal për çfarëdo çështje që përkon nën autoritetin komunal. Kuvendi Komunal duhet të konsiderojë peticionin në dakordim me Statutin dhe Rregulloren e Punës.

Iniciativat qytetare

Qytetarët lokal poashtu mund të propozojnë rregulla për miratim nga Kuvendi Komunal apo me votën e qytetarëve. Qytetarët duhet të paraqesin draft dokumentin për rregulla tek kryesuesi i Kuvendit Komunal. Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u marrë në konsideratë nga Kuvendi Komunal. Kuvendi Komunal është i obliguar që ta marrë në konsideratë rregulloren e propozuar dhe të ndërmarr veprim brenda 60 ditëve nga pranimi.

Referendumi

Qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregulloren e adoptuar nga Kuvendi Komunal të mund ta parashtrajnë për referendum. Kërkesa duhet të parashtrohet tek kryesuesi i Kuvendit Komunal brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores dhe duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të rexhistruar. Kuvendi Komunal duhet të ketë në konsideratë dhe duhet të veprojë pas kërkesës brenda 30 ditëve pas pranimit të peticionit valid.

Komisionet konsultative

Kuvendet Komunale poashtu mund të krijojnë komisione konsultative për çështje specifike me qëllim që të mundësojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendim-marrës. Anëtarësimi i komisioneve duhet të inkuadrojë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Komisionet konsultative mund të parashtrajnë propozime, ndërmarrin hulumtime dhe ofrojnë mendime në iniciativat e kuvendit komunal në perputhje me Statutin e Komunës.

III. Si t'i organizojmë qytetarët rreth një iniciative

Avokimi është një proces i gjatë i cili kërkon kohë dhe durim. Nuk ka rregulla të shkruara se sa duhet të jetë numri i njerëzve që kërkohen për një kampanjë të suksesshme avokuese, por në mënyrë gjenerale kampanjat më të fuqishme sjellin së bashku grupet e njerëzve të cilat punojnë drejt një qëllimi të përbashkët.

Kur grupet e njerëzve mblidhen së bashku rreth një çështje, hapi i parë më i rëndësishëm është që të qartësohet se me çka ka të bëjë iniciativa. Jo çdo problem është një diçka që mund të zgjidhet me kampanjë avokuese lokale. Më poshtë mund të gjeni kriteret më të rëndësishme që duhet mbajtur mend kur vendoset se cili problem duhet të preket:

E zgjidhshme në nivelin lokal

Pasiqë fokusohemi në kampanjat avokuese lokale, kriteri i parë është ai që problemi mund të zgjidhet nga autoritetet lokale. Referohuni tek përshkrimi i dhënë më lartë për një ide se cilat lloje të problemeve janë përgjegjësi e qeverisë lokale. Edhe po të ekzistojë vullneti i mirë në mesin e zyrtarëve lokal për të ndihmuar, ata nuk do të jenë në gjendje që të përgjigjen tek një iniciativë e cila është jashtë fushëveprimtarisë së autoritetit të tyre. Prsh, disa rrugë janë mirëmbajtur nga institucionet qendrore dhe të tjerat janë përgjegjësi e qeverisjes lokale.

Konkrete dhe të qarta

Iniciativat lokale duhet të jenë diçka specifike dhe të përfshijë rekomandime konkrete për atë se si të zgjidhet problemi. Grupet që dëshirojnë të zgjidhin probleme të përgjithshme sikurse përdorimi i drogës janë të pamundshme për të dhënë rezultat si një përgjigje nga zyrtarët lokal edhe në qoftë se pajtohen se është problem në komunitet. Në këtë shembull, qytetarët mund të avokojnë për diçka më konkrete e cila adreson një aspekt të problemit, siç janë prezantimet në shkolla për rreziqet e përdorimit të drogës. Është më së miri që të anashkalohe problemet e përgjithshme globale, siç është prsh papunësia.

E mundur ekonomikisht dhe politikisht

Edhe pse nëse një problem është konkret dhe mund të zgjidhet nga qeveria lokale, është poashtu me rëndësi të kemi në konsideratë se a ka mundësi financiare komuna të implementojë kërkesën. Shumë qeveri komunale nuk kanë buxhet të lartë e të mjaftueshëm që të ndërtoj një urë të re apo stadium sportiv, anipse do të ishte përfituese për qytetarët. Ngjashëm, çdo grup i aktivistëve qytetarë duhet të konsideroj nëse një iniciativë potenciale prek një çështje të ndjeshme politike. Problemet të cilat përfshijnë komplikime të caktuara politike, që do të thotë të cilat janë politikisht të ndjeshme mund të vihet në veprim por është e nevojshme që të përfshihen organizata apo aktivistë me përvojë, të cilët janë të gatshëm të ndërmarrin hapa të vazhdueshëm.

Me rëndësi për qytetarët e komunës

Në çdo komunitet lokal, ka gjithmonë një numër të problemeve potencial për të punuar në to. Pasiqë çdo komunë ka burime të kufizuara, kampanjat e suksesshme fokusohen në problem në të cilat njerëzit në mënyrë të përgjithshme pajtohen se kanë nevojë të adresohen. Grupe të ndryshme në komunitet mund të ballafaqohen me probleme të ndryshme, siç janë njerëzit duke jetuar në lagje të caktuara apo njerëz me nevoja të veçanta, atje ka me siguri shumë çështje se një kampanjë lokale avokuese mund të ndihmojë të zgjidh për grupe specifike. Gjëra të rëndësishme të mbash në mend për çfarëdo grupi është si të vë në prioritet problemet, dhe të fokusohet në çështje që janë më të rëndësishme. Prsh, prindërit me fëmijë do të donin të renovonin një shesh lojërash për fëmijë dhe të rregullojnë problemet e trafikut

përreth shkollës ku fëmijët i vijnë mësimet. Kampanja rreth sigurisë në trafik mund të fitojë më shumë përkrahje nga prindërit si një problem më urgjent që duhet të zgjidhet.



Qytetarët në Leposaviq organizuan një iniciativë duke kërkuar nga shkollat lokale që t'i ndriçojnë fushat e basketbollit gjatë natës në mënyrë që të mund të përdoren në mënyrë pozitive nga komuniteti

Hapi i parë për çfarëdo kampanje avokuese është që të marrësh një grup të qytetarëve së bashku që të diskutosh çështjet lokale. Nganjëherë një grup i vogël i cili është më i përfshirë, është më i mirë se sa një grup i madh i cili përfshin njerëzit të cilët janë më pak të interesuar – rreth 15 është numri ideal tipik të cilin ju do të doni ta sjellni së bashku. Ky mund të jetë një takim informal i cili mbledh një grup ekzistues të shokëve, ose një diskutim formal i udhëhequr nga një facilitator/ndihmës. Sido që të jetë, është me rëndësi që të kemi një plan të qartë për rendin e ditës apo për atë se çfarë do të diskutohet para se të sillen njerëzit së bashku. Në aneks, ju mund të gjeni një shembull të një rendi të ditës për një takim me qytetarë që të diskutohen problemet lokale.

Nëse grupi do të punonte në një iniciativë të avokimit lokal për herë të parë, planifikon që të ofrojë fillimisht një përshkrim të shkurtër. Në të shumtën e rasteve është më së miri që të pyetet grupi që në fillim të diskutimit, nëse janë të njohur me konceptin si dhe të përshkruhet me fjalë të tyre se çfarë kuptimi ka fjala avokim për ta. Në këtë mënyrë udhëheqësit e diskutimit mund të sigurohen se secili në grup është i gatshëm që të përcjellë diskutimin. Edhe po qe se biseda është më pak formale, qëndro fleksibil dhe mos u ndjeni se duhet që t'i përmbaheni rendit të ditës nëse është e qartë se grupi është i familjarizuar me temën apo nëse po kanë vështirësi me diskutimin dhe kanë nevojë për më shumë sqarime.

Në disa raste, grupet e qytetarëve kanë një çështje të caktuar në mendjen e tyre. Në atë situatë, diskutimi duhet të fokusohet në identifikimin e aspektit të asaj çështje e cila është e përshtatshme për kampanjën e avokimit lokal duke përdorur kriteret e lartëcekura. Nëse ka një grup i cili përgjithësisht do të dëshironte të jetë më aktiv në vendim-marrje, hapi i parë është që të identifikojë njerëzit të një mendimi që të ndajnë ide për probleme lokale dhe të përcaktojë iniciativat konkrete. Para se të hapet diskutimi për problemet lokale, kalo pak kohë që të shënosh kriteret të cilat janë të listuara më lartë

kështuqë bashkëbisedimi të jetë i fokusuar. Pas përshkrimit të katër kriterëve të cekura më lartë, nëse kanë edhe diçka për t'i shtuar listës, në mënyrë që të jenë të përfshirë në diskutim. Pasiqë është e qartë, ju mund të filloni që të shpalosni ide rreth problemeve të përbashkëta si dhe të listoni një varg çështjesh të cilat mund të përfshihen në kriteret e krijuara. Kur çdonjëri të ketë dhënë mendimet, pyeteni grupin se si do të dëshironin që të vendosnin se cilin problem do ta trajtonin si një iniciativë avokuese. Ka një numër mundësish se si të përcaktohet një gjë e tillë, me votë të hapur, duke i vendosur pikë tek çdo ide bazuar në kriteret, votim anonim në letër etj. Gjëja më e rëndësishme për grupin që të përfshihet në përcaktimin se si është arritur vendimi kështuqë ata të ndjehen se kanë investuar në rezultatin final. Është e mundur që grupi të vij me më shumë se një ide të mirë, por pika fillestare është më së miri të fokusohet në një iniciativë dhe të ketë suksesin e parë para se të kalojnë në problemin e dytë apo të tretë.

IV. Mbledhja e informacionit të duhur

Hapi tjetër pas identifikimit të një çështje lokale është që të mbledhësh më shumë informata. Përgatitja e grupit me të gjitha të dhënat e mundshme e fuqizon pozitën e juaj kur ju takoheni me zyrtarët. Në këtë mënyrë, grupi do të jetë më serioz dhe i aftë, dhe do të jetë e vështirë për institucionet që të injorohet. Poashtu, taktika e parë e cila me siguri se do të përpiqet të bëhet nga zyrtari, në mënyrë që të refuzojë kërkesën është se do të thotë se është shumë e kushtueshme, nuk është koha e duhur, se ka prioritete tjera dhe kështu me radhë. Ejani të përgatitur me informacione dhe shpenzime, kohën e vendimit për buxhet apo takime tjera komunale, apo niveli i interesimit në mes të qytetarëve ndihmon që të binden zyrtarët për nevojën e çështjes dhe i bën më pak të mundshëm që të refuzojnë kërkesën tuaj. Është më mirë që të marrë më shumë kohë që të bëhet një hulumtim i bërë me kujdes dhe të vini të përgatitur në takim se sa të vazhdoni para dhe gjërat t'i sillni tek zyrtarët sa për sy e faqe.

Për çështjen e dhënë, ka një varg pyetjesh për të sqaruar para se ta lansoni iniciativën:

Cilat institucione kanë përgjegjësi për këtë çështje?

Është kritike që të sigurohemi se grupi është duke e synuar personin apo zyrën e cila ka fuqi që të zgjidh problemin. Institucionet mund të thonë se nuk janë në gjendje të zgjidhin problemin si një mundësi që t'i ikin përgjegjësisë, kështuqë një kuptim i autoritetit të institucionit lokal siguron se qytetarët mund të kërkojnë llogaridhënie nga zyra e duhur. Mbani mend se në shumicën e rasteve institucione të

shumëfishta janë të përfshira në çështjen e dhënë, dhe në raste në Kosovë mund të ketë autoritet institucional të dyfishtë derisa qeveritë lokale zhvillohen. Kur bëni iniciativa, është më së miri të filloni në nivelin lokal para se të shkoni tek zyret e nivelit më të lartë apo të atij regional.

HEKURUDHA NË ZVEÇAN

Qytetarët në Zveçan e kanë kuptuar se portat tek dy kalimet hekurudhore në komunë nuk janë duke funksionuar, duke ngritur kështu rrezikun gjatë vozitjes. Pas vendimit të organizimit të një iniciative lokale që të rregullojë portat, aktivistët u takuan me përfaqësuesit e zyrës lokale të hekurudhës që të diskutojë çështjen dhe të shihen mundësitë se pse portat nuk janë riparuar. Në këtë takim, zyrtarët sqaruan se riparimi i portave do të kishte një shpenzim të madh e cila do t'i tejkalojë mundësitë e shumicës së qeverisjeve komunale. Pas marrjes së këtij informacioni, qytetarët vendosën që të ngrisin vetëdijen sa i përket çështjes dhe t'i nxisin vozitësit që të jenë të kujdesshëm tek kalimi hekurudhor. Aktivistët shpërndan fletushka në komunitet dhe krijuan një video vetëdijësuese për vozitje të kujdesshme.

Sa do të mund të kushtonte zgjidhja e ofruar?

Për shumicën e iniciativave, barrierë kryesore është çmimi. Posaqërisht në kontestin e Kosovës, qeveritë lokale shumë shpesh punojnë me buxhet të kufizuar. Nëse grupi i juaj bën disa hulumtime të thjeshta përbrenda çmimit të parashikuar të propozuar në iniciativë, ju do të mund të punoni në formë më bashkëpunuese me zyrtarët për të parë se nga ku do të mund të siguroheshin burimet. Mundohuni aq sa është e mundur që të jeni kreativ me rekomandime të propozuara dhe këni parasysh opcionet tjera të cilat janë më pak të kushtueshme. Në situatën kur një rezolutë e plotë e problemit do të jetë tepër e kushtueshme, qytetarët mund të avokojnë për hapat e parë apo së paku një vetëdije më e madhe në komunitet.



Qytetarët në Zveçan vendosin posterë afër kalimit hekurudhor që të ngrisin vetëdijen për portat e dëmtuara

Çfarë bëjnë organizatat/individët e tjerë për t'a përmirësuar këtë gjendje?

Mund të jetë ndonjë OJQ apo ndonjë grup tjetër aktivistësh që për momentin janë duke punuar në trajtimin e çështjes së njëjtë me zyrtarët. Duke i shikuar dhe planifikuar këto mundësi na siguron që të mos drejtojmë tek zyrtarët porosi të ndryshme nga qytetarët për çështjen e njëjtë. Poashtu do të ishte e dobishme për të mësuar se me çfarë sfidash janë ballafaquar të tjerët dhe të identifikojmë aleatët potencial të cilët mund të na bashkohen për ta bërë iniciativën më të efektshme.

Kur janë marrë vendimet për këtë çështje? A ka ndonjë program/orar të saktë?

Në mënyrë që të planifikoni një tabelë me iniciativën e juaj, është shumë me rëndësi që të jeni në dijeni për programin e qeverisjes lokale. Nëse institucioni përgjegjës do të duhet të kërkoj diçka shtesë nga buxheti, shpesh kjo mund të bëhet në kohë të caktuar. Poashtu mund të jetë ndonjë votim që do të ndodh në kuvend apo ndonjë vendim tjetër sa i përket çështjes që të ndodh sa më shpejt. Në çdo iniciativë duhet të kemi parasysh kohën e këtyre vendimeve që të sigurohemi se nuk do të humbim asnjë mundësi si dhe të planifikojmë aktivitetet që të kenë ndikimin më të madh të mundshëm. Në shumë komuna në Kosovë, mund të ndodh që nuk i përmbahen orarit të takimeve të rregullta në kuvend, kështuqë strategji e mirë është që të ndërtohen marrëdhëniet me deputetët apo me zyrtarë të tjerë të cilët mund të njoftojnë përfaqësuesit e iniciativës se kur do të thirret takimi.

A ka atje statistika relevante apo dëshmi personale që të vënë në pah rëndësinë e çështjes?

Nganjëherë zyrtarët do të duhet të binden se çështja e juaj është një prioritet. Të dhënat ashtu siç janë statistikat mbi krimin, hulumtime joformale të komunitetit, apo edhe përmbledhja e tregimeve personale nga individët e prekur mund të ketë një ndikim të fuqishëm tek zyrtarët.

Çfarë thotë ligji rreth kësaj çështje? A është duke e gjetur kjo iniciativë zbatimin e duhur në ligjin ekzistues, apo ka nevojë që të ndryshohet ai ligj?

Njohuria rreth ligjeve është shumë relevante me iniciativën e juaj për të përcaktuar se çfarë në të vërtetë grupi do të duhej të sugjeroj si një zgjidhje. Kryerja e këtij hulumtimi mund të vë në pah se institucionet lokale janë veçse të obliguara që të ofrojnë një shërbim të caktuar. Grupi poashtu mund të zbuloj se iniciativa e tyre mund të kërkoj një ndryshim të urdhëresës lokale për qeverinë në mënyrë që të vazhdoj me kërkesën. Kjo të shumtën e rasteve mund të jetë e vështirë të përcaktohet në Kosovë, por prapëseparë mund të krijoj një ndikim në strategjinë e gjithëmbarshme avokuese.

Jo të gjitha pyetjet janë relevante për çdo çështje, dhe atje mund të ketë edhe pyetje shtesë që të qartësohen para se të finalizohet plani për iniciativën e juaj. Mbani një diskutim të hapur brenda grupit nëse diç tjetër mund të jetë me rëndësi për hulumtim. Pasiqë grupi është dakorduar me listën e

pyetjeve, hapi i radhës është që të gjendet burimi më i mirë i informacionit. Keni parasysh se shpesh shumë pyetjeve mund të ju gjindet përgjigja nga personi i njejtë apo në takimin e njëjtë. Pas identifikimit të burimeve të nevojshme, caktoni anëtarët e grupit për takime apo hulumtime të cilat ju veçse i keni identifikuar si të rëndësishme. Duhet të jetë i përcaktuar shumë qartë afati kohor për të kompletuar këtë mbledhje të informatave. Është e preferuar që këto informata të mblidhen maksimum brenda dy javësh, pasi që stërzgjatja deri në tre javë nuk është aspak e preferuar. Nëse disa anëtarë të grupit kanë vështirësi për të caktuar takimet e planifikuara, mblidhni grupin që të mbani momentumin duke shkëmbyer informatat që të tjerët kanë mundur t'i mblidhin në ndërkohë.

Hapi final në mbledhjen e informatave është që të shkëmbejmë ide me të gjithë partnerët e interesuar – të cilët mund të jenë për apo kundër, dhe pse? Mendimi kreativ për atë se kush mund të jetë kundër iniciativës së juaj do të ju ndihmojë që të përgatitni grupin që të krijoni tema të diskutimit dhe strategji që i marrin këto brenga potenciale në shqyrtim dhe i bindin vendim-marrësit se sugjerimet e propozuara janë më të mirat. Prsh, një iniciativë e cila ka për qëllim që të përmirësojë ndriçimin publik mund të të ballafaqoj me kundërshtimin të cilët nuk duan që poçi i instaluar jashtë të ndriçojë dritaret e tyre. Kjo iniciativë duhet të përgatitet me kundërgargumentin se pse siguria e qytetarëve të cilët qarkullojnë në këtë pjesë duhet të mirret parasysh përkundër brengës së banorëve të ndërtesës.

Si pjesë e këtij ushtrimi të shkëmbimit të ideve, identifikoni njerëzit apo institucionet të cilët sipas të gjitha gjasave do të jenë të interesuar që të zgjidhin këtë problem dhe të cilët janë më së shumti të prekur. Prsh, iniciativat e suksesshme organizuar nga ACDC në Zveçan sa i përket sigurisë në trafik rreth një shkolle fillore identifikuar nga vetë këshilli i prindërve si një grup lokal i interesit të veçantë. Kur këto grupe të identifikohen, bëni hulumtime sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që t'i ftoni që të jenë pjesë e iniciativës. Gjatë kohës, zakonisht ndodh që grupi do të ndryshojë pasi që një ndër anëtarët e parë që janë përfshirë bëhen më pak të përfshirë derisa njerëzit e tjerë fillojnë t'i bashkangjiten grupit e të cilët janë më së shumti të prekur nga çështja.

V. Krijimi i planit të veprimit

Gjetja e përgjigjeve në pyetjet e shtruara më lartë do të ju ndihmojë grupit të juaj se cilat veprime të ndërmerren në mënyrë që të promovoni iniciativën e juaj. Mënyra më e mirë për të organizuar këto ide dhe aktivitete është që të krijoni një plan të veprimit. Planet e veprimit janë dokumente të cilat i listojnë aktivitetet e parapara, kush është përgjegjësi, dhe ku do të ndodhin. Krijimi i një plani të përbashkët mundëson që secili në grup të pajtohet për mënyrën se si të ecim përpara, dhe është shumë i dobishëm për të qenë i sigurt se ju jeni duke e shpenzuar kohën dhe burimet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Hapi i parë gjatë përpilimit të planit të veprimit është që të mblidhet grupi dhe të rishikohen materialet e secilit që ka mbledhur. Kjo përafërsisht do të duhej të merrte kohë afro një apo dy javë kohë pas përcaktimit të planit hulumtues për t'u siguruar se e keni në dorën e juaj momentumin. Tanimë që grupi i juaj e ka të qartë se kush është përgjegjës për çështjen, kur bëhen vendimet e rëndësishme, si dhe informacione të tjera relevante ju mund të filloni të shkëmbeni ide për aktivitetet të cilat do t'a shtynin iniciativën e juaj përpara tek zyrtarët dhe institucionet. Më shumë detaje për llojet e aktiviteteve të cilat do të mund të keni për kampanja lokale mund të gjenden në seksionin e ardhshëm.

Planet e veprimit do të ndihmojnë të organizoni idetë. Ato duhet gjithmonë të shtojnë afatet kohore dhe të përditësohen rregullisht të merren parasysh ndryshimet në situatë në terren dhe reagimet e zyrtarëve nga aktivitetet e mëhershme. Planet e veprimit janë të ndara në çfarë, pse, kush, si dhe kur:

ÇFARË?

Përshkruan aktivitetin apo ngjarjen

PSE?

Shpjegon se kush është synim i aktiviteteve dhe si mund të ndihmohet të arrihet qëllimi juaj

KUSH?

Qartë liston se cili anëtar i grupit është përgjegjës për organizimin e aktivitetit

SI?

Shpalos se cilat burime janë të nevojshme që të vazhdojmë tutje (fletushka, fanela etj), përfshirë edhe shpenzimet

KUR?

Përcakton se cila është koha më e mirë që të organizohen këto ngjarje për ndikimin maksimal që duhet të kenë

Për çdo aktivitet apo ngjarje, përfshini planin për ftesën për media – ngjarjet të cilat janë të hapura për publik, dhe ato të cilat janë takime të mbyllura me zyrtarë. Ka momente kur presioni i mediave mund të jetë ndihmesë për të vazhduar një iniciativë tutje, por në disa raste përfshirja e medias mund të jetë problematike për marrdhënien e ndërtuar me zyrtarë.



Një iniciativë qytetare në veri të Mitrovicës gjatë një konference për shtyp me gazetarë

Pas çdo aktiviteti, rishikoni planin e veprimit dhe përcaktoni nëse ndonjë ndryshim është i nevojshëm duke u bazuar në reagimet nga publiku dhe zyrtarët. Poashtu mund të jetë e dobishme që të caktohet një kohë e rregullt për të plotësuar planin e veprimit (një apo dy herë në muaj) nëse iniciativa është e fokusuar në shtrirje të informatës se sa në ngjarje të mëdha. Në mënyrë që grupi të jetë i koordinuar, përpiloni planin e komunikimit që të jeni në kontakt. Jini të sigurt se atje ka një plan të qartë se kush është përgjegjës për të rifreskuar grupin me informacione të reja, dhe të mos jenë vetëm premtime në ajër se do të mbesim në kontakt. Grupet në Facebook dhe Viber mund të jenë më efektivet, por është me rëndësi që të pyetet grupi se çfarë është më e përshatshme për ta.

VI. Strategjitë për të ndikuar tek zyrtarët

Ka shumë mënyra për t'u siguruar se iniciativat lokale dëgohen në mënyrë të suksesshme nga institucionet lokale. Mbani mend se aktivitete të ndryshme mund të kenë më shumë sukses për iniciativa të caktuara apo në vende të caktuara. Disa nga instrumentet për të përfituar interesin e tyre për të zgjidhur problemet e juaja në nivelin lokal janë:

Çasja ndaj mediave

Për të gjitha aktivitetet, është me rëndësi që të keni plan se si të shpërndani lajmin për iniciativën e juaj. Mediat sociale të shumtën e rasteve janë më të efektshme në nivelin lokal, posaqërisht Fejsbuku si një rrjet social më i popullarizuar në Kosovë. Duke krijuar një web faqe zyrtare në Fejsbuk me emrin e iniciativës do të ishte promovimi më i mirë që të ftohen qytetarët e tjerë të interesuar që të jenë pjesë dhe të bëhen anëtarë të grupit tuaj.² Bashkë me mediat sociale, medioni edhe për ëeb faqet e lajmeve apo stacioneve televizive ë mund të jenë të interesuara për çështjen e juaj. Çdoherë kur grupi i juaj përgatitet për një aktivitet të caktuar, dërgoni një e mail zyrtar tek të gjitha mediat të cilat mendoni se do të ishin të interesuara për t'a mbuluar ngjarjen. Në rast të caktuar të implmentimit të iniciativës suaj, një konferencë për shtyp me gazetarë rreth çështjes dhe veprimeve do të sihin mundësi e mirë për të promovuar punën e grupit tuaj.

Mediat mund të jenë aleatë të juaj kur implementoni aktivitete, posaqërisht nëse ka media të cilat veçse kanë adresuar çështjen e njëjtë. Gjatë dërgimit të ftesave për ngjarjet e juaja, përdorni çdo mundësi për paraqitje të mysafirëve në radio/TV emisione në mënyrë që të promovoni iniciativën e juaj dhe shpjegoni tek masa e gjerë se pse iniciativa e juaj është e rëndësishme dhe se si mund të tjerët ta ndihmojnë. Ky lloj ii çasjes në media poashtu ka për qëllim të demonstrojë tek vendim-marrësit lokal se grupi i juaj është serioz rreth iniciativës suaj. Lloje të tjera të ngritjes së vetëdijes sikurse panot, posterët dhe fletushkat mund të jenë një mënyrë e mirë për të promovuar aktivitete të caktuara apo të përfshijë më shumë njerëz nëaktivitetin e juaj në përgjithësi.



Logo e iniciativës qytetare "Siguria në trafik për fëmijët" në Zveçan

Ngjarjet publike

Duke i mbledhur grupet përkrahëse së bashku në publik mund të jetë një demonstrim i fuqishëm i nevojës së çështjes si dhe nevojës për ndryshim. Turma të çastit/Flash mobs, marshimet apo edhe ahengje mund të krijojnë presion tek institucionet për t'u përgjigjur. Prsh, iniciativat avokuese për ndriçim më të mirë në rrugë në rajone të caktuara mund të organizojnë vullnetarët me bateri dore të cilët ecin në atë pjesë të cilën ju doni ta përmirësoni. Aktivitetet publike vullnetare si prsh., mbjellja e luleve apo pastrimi i parkut mund të jenë poashtu një ndër strategjitë e gjithëmbarshme të demonstrimit të rëndësisë së një

çështje tek zyrtarët lokal. Për këto lloje të ngjarjeve, ftoni përfaqësuesit e mediave dhe bëni një ngjarje zyrtare në faqen e Fejsbukut rreth iniciativës në mënyrë që të mbledhni sa më shumë qytetarë.

² Prsh shih faqen zyrtare të "Siguria në trafik për fëmijët – Zveçan" (Siguria e fëmijëve në trafik – Zveçan) në: <https://www.facebook.com/Siguria-fëmijëve-në-trafik-Zveçan-863451663751435/>


Peticionet joformale apo letrat përkrahëse

Një strategji tjetër për të demonstruar rëndësinë e një çështje është mbledhja e nënshkrimeve nga qytetarët në përkrahje të çështjes. Kjo nuk ka nevojë që të jetë gjithmonë pjesë e peticionit formal duke i përdorur mekanizmat e përshkruara në pjesën e lartëcekur. Nganjëherë të përshkruash këtë aktivitet si një letër përkrahëse mund të jetë një rrugë e duhur për të i'u afruar zyrtarëve pa u dhënë atyre ndjesinë e sfidës apo kërcënimit tek institucionet.

ANKETA E STUDENTËVE NË MITROVICË

Studentët në veri të Mitrovicës kanë identifikuar një problem lokal të rritjes së kriminit ndaj studentëve, posaqërisht në lokacionet e qytetit me ndriçim të dobët apo mungesë të prezencës policore. Në mënyrë që të marrin më shumë informacione se saktësisht në cilat lokacione janë më kritike, aktivistët organizuan një anketë me komunitetin me fokus studentët e ku u pyetën përgjithësisht për mendimin e tyre sa i përket sigurisë në qytet si dhe se kur e kanë ndërvehten më pak të sigurt. Vullnetarët shpërndan anketat në universitet si dhe online përmes iniciativës së tyre në faqen e Fejsbukut. Duke dashur të dijnë se cilave rrugë t'u japin prioritet, anketat i ndihmuan kësaj initiative seriozitetin e rastit si dhe përkrahjen e gjerë të studentëve për këtë iniciativë.

së



Studentët aktivistë në veri të Mitrovicës shpërndajnë anketa joformale tek komuniteti në universitet sa i përket sigurisë së studentëve

VII. Duke i përcjellur premtimet nga zyrtarët

Edhe nëse zyrtarët kanë premtuar se do të bëjnë atë që është kërkuar nga grupi, është gjithmonë me rëndësi që të përcillet dhe të shikohet se a po realizohet ajo që është premtuar. Fillimisht, ju ndihmon që të keni një informacion të qartë për atë se kur mendojnë ta përmbushin kërkesën e cila vjen nga iniciativa e juaj bazuar në burimet që ka institucioni lokal. Në këtë mënyrë ju mund të përpiloni planin për të përcjellë në kohë reale dhe do të shmangni çfarëdo dëmtimi të mardhënieve me zyrtarët për të evituar mospërputhjet rreth implementimit. Mënyra më e mirë është që personi personalisht të shkoj dhe të monitoroj implementimin. Prsh, nëse iniciativa e juaj ka për qëllim që të vendos një shenjë trafiku, të shkoj atje personalisht dhe të monitoroj se a është vendosur e njëjta. Nëse kërkesa e juaj është një shërbim tjetër apo procedurë zyrtare siç është prezantimi nga zyrtarët policor tek studentët, dërgo një anëtar të grupit të përcjellë se a po mbahet ai prezantim gjegjësisht a po kryhet ai shërbim. Keni parasysh se iniciativa mund të mos përfundoj kur institucionet veprojnë, pasi që mund të jenë nevoja shtesë të përmirësohet situata.

Nëse institucionet nuk i kanë përmbushur premtimet bazuar në planin e aktiviteteve, më së pari kontaktoni zyrtarët për t'u njoftuar se pse ka ndodhur diçka e tillë, para se të drejtoheni tek mediat apo të organizoni ndonjë ngjarje publike. Mund të ketë arsye të pranueshme se pse institucionet nuk kanë mundur të kompletojnë tërë hapat, dhe duke kritikuar zyrtarët publikisht para se të jepni mundësinë atyre që të shpjegojnë rastin mund të krijohet një dëmtim i këtyre mardhënieve. Njëjtë, nëse implementimi ndodh sipas agjendës së përcaktuar, është ide e mirë që ju të tregoni mirësi dhe falënderim për zyrtarët me një letër zyrtare falënderuese apo me një komunikatë për shtyp. Në këtë mënyrë ju keni krijuar një mardhënie pune pozitive dhe me siguri se ata do të jenë më të afërt për bashkëpunim në të ardhmen.

Në shumë raste, zyrtarët do të thonë “kjo nuk mund të bëhet tani, por kur të diskutojmë buxhetin e ardhshëm do të përfshijmë këtë propozim”. Nëse institucionet thonë sedo të planifikojnë të përfshijnë iniciativën më vonë në buxhetin e ardhshëm, merni një informacion të qartë se kur do të krijohet ky buxhet/apo kur do të votohet. Në ndërkohë kini parasysh që t'i rikujtoni zyrtarit tuaj për premtimin e bërë sa i përket buxhetit.



Iniciativa qytetare në Zubin Potok filmon një video për sigurinë në trafik që të ju rikujtoj zyrtarëve për premtimet e tyre për të vendosur pengesat në rrugën kryesore

VIII. Konkluzioni dhe këshillat për strategjitë e suksesshme avokuese

Derisa i kompletojmë hapat e cekur më lartë, ka disa gjëra të përgjithshme që duhet mbajtur në mend e të cilat do të ndihmojnë iniciativën e juaj të jetë e suksesshme. Më e rëndësishmja është se mënyra më e mirë që të ju ofroheni zyrtarëve është qëllimi që të krijohet një mardhënie pozitive – shumë institucione do të reagojnë negativisht tek një grup i cili kritikon pa dashur që së pari të takohen bashkë. Demonstroni se ju jeni serioz, të përkushtuar, dhe të informuar sa i përket përgjegjësive karshi qytetarëve. Poashtu, mendoni për iniciativa si një mundësi e një mardhënie më të gjatë me zyrtarët, dhe tentoni sa më shumë që mundeni që të krijoni lidhje pozitive të cilat do të ju mundësojnë më lehtë të përballeni me çështjet në të ardhmen të cilat qytetarët do të mund t'i shtrojnë.

Nganjëherë institucionet mund të pyesin për kërkesën zyrtare apo shkresë – qartësoni me ta se çfarë formati kërkohet, se a është kjo politikë e preferuar nga zyra e tyre. Siç zhvillohet situata në Kosovë, mund të ndodh që zyrtarët nuk janë gjithmonë sigurt se cila është procedura e drejtë. Merrni një çasje bashkëpunuese, por njëherit sigurohuni se jeni të njohur me procedurat sa më shpejt që është e mundshme. Duke lexuar ligjet zyrtare, hulmutime në internet, dhe njëherit gjeni nëse ndokush e ka një sfidë të ngjashme e gjithë kjo mund të ju ndihmojë në raste të tilla. Jeni të gatshëm që të përgatitni dokumentin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundshme që të demonstroi seriozitetin e juaj dhe vullnetin për bashkëpunim. Pas dërgimit të dokumentit të kërkuar, prisni për një përgjigje formale, por jo gjatë. Nëse nuk ka ndonjë përgjigje zyrtare, vizitoni zyrën edhe njëherë, shkruani një e-mail apo telefononi sipas nevojës, por mos i lejoni institucionet të mendojnë se qytetarët kanë hequr dorë, pasi që nuk kanë marrë përgjigje në kërkesën e shtruar.

Duke patur parasysh rolin e donatorëve dhe projekteve të OJQ-ve në Kosovë, zyrtarët mund të mendojnë se ju keni buxhet të mjaftueshëm për t'u marrë me iniciativën dhe të ju kërkojnë kontribut financiar. Jini i qartë sa i përket kësaj se burimet e grupit tuaj që nga fillimi dhe si do të shpërndahen ato. Mos premtoni shumë, por jini të gatshëm që të bëni kompromis me vendim-marrësit. Kurrë mos lejoni që të gjendeni në pozitë si të papërgatitur, joprofesional dhe jo shumë të përkushtuar. Ju bëni me dije se ju jeni të vetëdijshëm për të drejtat e juaja dhe të përgatitur që të mbani momentumin e iniciativës suaj, edhe pse ju mund të mos keni një çasje të shpejtë në fillim.



Aktivistët në Veri të Mitrovicës rehabilituan parkun lokal për të sjellur vëmendje dhe presjon tek zyrtarët të zonës në mënyrë që të rregullohen dritat për-rreth.

Edhe pse procesi i avokimit mund të jetë i ngadalshëm dhe nganjëherë frustrues, përfitimi i krijimit të institucioneve më të përgjegjshme dhe zgjidhje më e mirë për problemet e bën këtë angazhim shumë të çmuar. Qytetaria aktive përmes avokimit është një proces që vazhdon dhe që është qenësor për funksionimin demokratik të shoqërisë. Çasja dhe rekomandimet e cekura në këtë manual na dërgojnë tek një kampanjë e suksesshme avokuese në katër komunat në veri të Kosovës, duke demonstruar fuqinë e qytetarëve të organizuar rreth një kauze të përbashkët. Të përfshira më poshtë janë shembujt e rendit të ditës/agjendave të takimeve me publikun që të diskutohen çështjet lokale të avokimit, si dhe një mostër për planin e veprimit në një iniciativë avokuese. Këto materiale mund të jenë pika fillestare për të bërë bashkë qytetarët në kërkim të ndryshimit.

IX. ANEKSET



Shembull i Rendit të ditës – Trajnimi i parë, hyrje në avokim

[Datë]

Koha	Tema
11.00- 11.10	Hyrje, rishikim i projektit
11.10- 11:35	Çfarë është avokimi dhe cilat janë të drejtat e juaja si qytetarë
11:35-11:45	Shembulli i një kampanje të suksesshme avokuese
11:45- 12:00	Pauzë
12.00- 12:10	Prezantimi i partnerëve në tabelë
12:10- 12:30	Puna në grupe të vogla në analizën e palëve të interest
12:30- 12:50	Prezantimi
12:50- 13:00	Diskutimi mbi hapat e ardhshëm dhe aranzhimi i trajnimit të radhës
13:00	Dreka



Shembull Rendi i ditës – Trajnimi i dytë, identifikimi i çështjes

[Datë]

Koha	Tema
11.00- 11.05	Hyrje, përmbledhje e trajnimit të mëparshëm
11.05- 11:35	Institucionet lokale në Kosovë
11:35- 11:40	Pauzë
11.40- 11:55	Kriteret për zgjidhjen e çështjes
11:55- 12:20	Diskutimi mbi problemet lokale
12:20- 12:25	Votimi
12:25- 12:45	Analiza e palëve të interes
12:45- 13:00	Plani hulumtues
13:00	Dreka



Shembull Rendi i ditës – Trajnim i kombinuar i avokimit dhe identifikimit të çështjes

[Datë]

Koha	Tema
11.00- 11.10	Hyrje, rishikim i projektit
11.10- 11:20	Rishikim i avokimit
11:20-11:30	Shembull i një kampanje të suksesshme avokimi
11:30- 11:45	Kriteret për një përzgjidhje të çështjes
11:45- 12:00	Diskutim i problemeve locale
12:00- 12:10	Votimi
12:10- 12:35	Analiza e palëve të interesit
12:35- 13:00	Plani hulumtues
13:00	Dreka

Kalendari i aktiviteteve

E përditësuar: [DATË]

[Titulli i aktivitetit]						

[Titulli i aktivitetit]						

[Titulli i aktivitetit]						

[Titulli i aktivitetit]						